



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Mars 2020

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2020

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020  
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [amanda.kojku@financa.gov.al](mailto:amanda.kojku@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Mars 2020 arriti në 110.2 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Mars 2020 ishte 2.1 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Mars 2020 ishte 112.08 lekë për dollarë dhe 124.31 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Mars 2020 shënuan kuotën 0.44 për qind për ato 12-mujore; 0.35 për qind për depozitat 6-mujore; 0.17 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.70 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.56 për qind për huatë 12-mujore dhe 6.75 për qind për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.365.360 milionë lekë në muajin Mars, duke shënuar një rritje prej rreth 6.8 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e katërt të 2019-ës rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 73.0 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar - Mars 2020 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 2.8 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 2.5 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Mars 2020, arritën në rreth 104.160 miliardë lekë ose afërsisht 90% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 106.948 miliardë lekë ose rreth 95% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2020 ishte +2.1%. Ndërsa një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.1%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Mars 2020 shënoi rritje prej 0.6 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Gjithashtu për muajin Shkurt 2020 indeksi shënoi rritje prej 0.4 përqind, krahasuar me muajin parardhës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Mars 2019 pësoi rënie prej 0.3 përqind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Mars 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4.6%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 2.4%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1.7%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0.9% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1.5%, pasuar nga “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” me 0.6% përkatësisht etj.



**Ndryshimi mujor i indeksit është 0.6%.** Krahasuar me muajin Shkurt 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 1.8%, pasuar nga grupet “Shëndeti” me 0.3%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0.2%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.1%.

Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 2.2%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.5%, “Komunikimi” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0.1% secili.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2019</b>	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.5	1.3	1.3	1.4	1.2
<b>2020</b>	1.5	1.2	2.1									


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2020, arriti në 124.31 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 1.79 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 130.66 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2020 arriti në 112.8 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.13 përqind kundrejt muajit Shkurt 2020. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 118.75 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 0.54 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 1.40 përqind. Në përgjithësi, forcimi i lekut në vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të riskut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.90 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2020, normat e interesit të depozitave me afat 1 dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.70 dhe 0.44 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 3 dhe 6 mujore që arritën kuotën 0.17 dhe 0.35 përqind përkatësisht.


Normat e interesit të depozitave 3, 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.03, 0.08 dhe 0.02 pikë përqindje respektivisht, ndërsa normat e interesit të depozitave 1 mujore kanë pësuar rënie mujore me 0.06 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.14, 0.21 dhe 0.13 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore me 0.15 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Mars 2020 arritën përkatësisht kuotën prej 6.75 dhe 6.56 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 mujore kanë pësuar rënie mujore prej 0.03 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.30 pikë përqindje. Gjithashtu, krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 mujore pësuan rënie vjetore prej 0.94 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të huave 12 mujore shënuan rritje vjetore prej 0.67 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Mars 2020 arritën nivelin 1.98 përqind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.11 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.84 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshem i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2019 rezultoi negativ në rënie të mjeteve të rezervës, prej rreth 73 milionë euro. Tremujori i katërt i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 346 milionë euro ngushtuar në terma vjetorë me rreth 26 milionë euro (ose 7%). Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 320 milionë euro, në rënie me 10 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënuan 103 milionë euro nga 586 milionë euro të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2018 përfshirë këtu emetimin e eurobondit të qeverisë.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 3,193 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 6%. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 346 milionë euro, rreth 7% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Ecuria e deficitit korrent ka reflektuar zgjerimin e balancave pozitive në shërbime dhe të ardhura dytësore. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e katërt të 2019 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -842.9 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 273.0 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -48.9 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 272.3 milionë euro.



**Bilanci i Pagesave per T4 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë



**Llogaria Korente per T4 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë





## 5. Mjetet Valutare Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2020, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 48.521 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2019. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës paradepozituese me 35.069 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 36.061 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 23.644 milionë lekë e bankës qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.365.360 milionë lekë në muajin Mars 2020, duke shënuar rritje prej rreth 87.398 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 6.8 përqind.

Gjithashtu në muajin Mars 2020, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 34.436 milionë lekë ose 2.6 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2020 arriti në rreth 597.387 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 50.044 milionë lekë, ose rritje me rreth 9.14 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (50.5%) dhe monedhave të huaja (49.5%).

Gjatë muajit Mars 2020, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 59.4 përqind ose 355.040 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 33.94 përqind ose 202.755 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.19 dhe 2.35 përqind apo 25.033 dhe 14.030 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Mars 2020, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.69 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.21 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.08 përqind dhe rreth 2.02 përqind.



## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 293.732 milionë lekë në fund të muajit Mars 2020. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2020 ka pësuar rënie mujore prej 0.21 përqind, dhe rritje vjetore prej 0.02 përqind, duke arritur nivelin 21.5 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.34 përqind, dhe rritje vjetore prej 0.03 përqind, duke shënuar nivelin 27.4 përqind.

Fig-11




**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2020, kanë shënuar rritje vjetore prej 55.476 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.7 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2020 shënuan rritje prej 12.921 milionë lekë në krahasim me muajin Mars 2019. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.2 përqind të tyre.

Fig-12



**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2020, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.2 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.9 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.7 përqind dhe rreth 16.3 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.4 përqind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 872.004 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (158.241 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (20.694 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (19.063 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.624 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Mars 2020, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.071.628 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 29.784 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 68.397 milionë lekë.



Fig-13

**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë




Fig-14

**Përberja e depozitave Mars 2020**

Burimi: Banka e Shqipërisë


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Mars 2020 janë mbledhur rreth 104.160 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 106.948 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 95.490 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 11.458 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 28% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 69.240 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 4.035 miliardë lekë (ose rreth 82% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 23.725 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 6.041 miliardë lekë (ose rreth 110% e planit për periudhën Janar - Mars 2020).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 95.490 miliardë lekë, 18.700 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.004 miliardë



lekë (9%) për shpenzime interesi, 9.389 miliardë leke (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 183 miliardë lekë (0.2%) për subvencione, 39,586 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 10.674 miliardë lekë (11%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 7.252 miliardë lekë (8%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 23% (shpenzime personeli), 22% (shpenzime për interesat), 19% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 14% (subvencione), 21% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 19% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 29% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 16%, ndërsa financimi i huaj është 11% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Mars 2020 ishin rreth 104.160 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 97.001 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 6.041 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Mars 2020 (mld Lekë) Revenues during March 2020 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Mars '20 March '20	Mars '19 March '19	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	8.92	10.83	-17.6
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.40	0.57	-29.2
	Akcizat (Excise)	3.46	3.83	-9.7
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	4.58	7.60	-39.7
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.34	2.78	-15.6
	Taksat nacionale (National Tax)	2.39	2.04	17.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars - 2020

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: March - 2020

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej -2.8 miliardë lekë gjatë periudhës Janar - Mars 2020, u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Mars 2020, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32.978 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 39.441 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Mars 2020, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 30.0 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 30.6 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 8.8 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1																
Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	February
<b>Mars</b>	0.5	0.4	0.3	-0.3	<b>0.6</b>	0.8	0.8	0.9	0.6	<b>0.9</b>	0.3	2.1	2.0	1.1	<b>2.1</b>	<b>March</b>
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2		0.5	0.5	0.5	0.4		0.3	1.9	2.1	1.4		April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0		0.2	0.1	0.2	0.1		0.7	2.0	2.1	1.5		May
Qershhor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3		0.04	0.0	0.1	0.1		1.2	2.2	2.4	1.3		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1		0.04	0.0	0.1	0.0		1.9	2.0	2.3	1.5		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3		0.14	0.1	0.1	0.1		2.0	1.6	2.2	1.5		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1		0.17	0.1	0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2		0.13	0.1	0.1	0.0		1.5	1.9	1.9	1.3		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2		0.12	0.1	0.1	0.0		1.9	1.7	1.8	1.4		November
Dhjetor	0.9	1.0	1.1	0.8		0.19	0.2	0.2	0.1		2.2	1.8	1.8	1.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020			Currency
						Janar	Shkurt	Mars	
						January	February	March	
<i>Mesatarja e periudhës</i>									<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	109.94	110.06	111.94	112.08	USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	122.17	122.08	122.13	124.31	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>									<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	110.71	111.38	118.75	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	122.13	122.74	130.66	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



**Tab - 3** Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)  
Annual Interest Rates (in ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020			
Në përqindje						Janar	Shkurt	Mars	In percent
						January	February	March	
<b>Norma e depozitave</b>									Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.43	0.40	0.42	0.44	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.41	0.48	0.27	0.35	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.17	0.40	0.14	0.17	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.72	0.81	0.76	0.70	1-M
<b>Norma e huasë</b>									Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.82	6.73	6.26	6.56	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	6.34	6.87	6.78	6.75	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>									Securities rates
Bono thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	1.29	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.50	-	-	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.69	1.77	1.87	1.98	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2020

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>36,012</b>	<b>71,182</b>	<b>104,160</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>204</b>	<b>785</b>	<b>1,118</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>34,315</b>	<b>66,979</b>	<b>97,001</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>23,535</b>	<b>46,931</b>	<b>69,240</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,493	22,929	31,850	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,255	4,506	9,086	Profit Tax
3	Akcizat	3,399	6,750	10,215	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,459	6,109	8,457	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,478	5,682	8,272	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	451	955	1,359	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,229</b>	<b>2,943</b>	<b>4,035</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	265	576	763	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	16	237	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	957	2,352	3,035	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>9,551</b>	<b>17,105</b>	<b>23,727</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	8,205	14,780	20,538	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,339	2,324	3,187	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,492</b>	<b>3,418</b>	<b>6,041</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		0	1,398	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	986	2,223	3,170	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>32,517</b>	<b>67,507</b>	<b>106,948</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>31,951</b>	<b>64,876</b>	<b>95,490</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>6,184</b>	<b>12,428</b>	<b>18,700</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,301	10,650	16,028	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	877	1,753	2,631	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>4,289</b>	<b>6,487</b>	<b>9,004</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	3,123	4,766	6,598	Domestic
2	Të Huaja	1,165	1,721	2,406	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>2,431</b>	<b>6,063</b>	<b>9,389</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveconet</b>	<b>64</b>	<b>126</b>	<b>183</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>13,486</b>	<b>27,854</b>	<b>40,287</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	10,290	20,441	29,980	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,715	6,712	9,606	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>2,499</b>	<b>6,841</b>	<b>10,674</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>2,995</b>	<b>5,077</b>	<b>7,252</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	43	87	135	Unemployment insurance benefits
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>		<b>0</b>		<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>567</b>	<b>2,632</b>	<b>11,458</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	-1	646	8,038	Domestically financing
2	Financimi Huaj	568	1,901	3,255	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetuara</b>				<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>3,495</b>	<b>3,675</b>	<b>-2,788</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-3,495</b>	<b>-3,675</b>	<b>2,788</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-2,416</b>	<b>-1,680</b>	<b>5,859</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	2	29	58	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	5,408	8,635	10,735	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,826	-10,344	-4,934	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>-1,078</b>	<b>-1,995</b>	<b>-3,071</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	364	1,565	3,507	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	184	364	767	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-441	-1,257	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,448	-3,119	-5,320	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore		0		Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2020**

Table of investments 2020

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë (in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Financim i brendshëm</b>	- 2,416	- 1,680	5,859	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	69.1	45.72	210.2	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	- 1,078	- 1,995	3,071	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	30.9	54.28	-110.2	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-3,495</b>	<b>-3,675</b>	<b>2,788</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

**TË ARDHURAT DOGANORE 2020**  
**CUSTOMS REVENUES 2020**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	451	955	1,359	Customs Duties
TVSH	7,434	15,763	22,596	V.A.T
Akcizë	3,399	6,750	10,215	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	246	465	661	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>11,530</b>	<b>23,933</b>	<b>34,832</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)**

TVSH	4,059	7,166	9,254	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,255	4,506	9,086	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,459	6,109	8,457	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,232	5,217	7,611	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>12,006</b>	<b>22,997</b>	<b>34,408</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>23,535</b>	<b>46,931</b>	<b>69,240</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2020

The Deficit and Its Financing for 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>36,012</b>	<b>71,182</b>	<b>104,160</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>32,517</b>	<b>67,507</b>	<b>106,948</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>3,495</b>	<b>3,675</b>	<b>-2,788</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-3,495</b>	<b>-3,675</b>	<b>2,788</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-2,416</b>	<b>-1,680</b>	<b>5,859</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	1,501	3,103	3,750	Treasury bills
b. Obligacione	3,921	5,559	7,027	Bonds
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	5,162	5,025	9,388	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	5,485	6,866	12,579	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-323	-1,841	-3,191	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	-49	-114	27	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	2	29	58	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-12,939	-15,255	-14,350	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-15	-27	-41	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>-1,078</b>	<b>-1,995</b>	<b>-3,071</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	364	1,565	3,507	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	6	-441	-1,257	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-1,448	-3,119	-5,320	Repayments
d.Mbeshtetje Buxhetore	0	0	0	Budgetary Support
Burimi: Ministria e Financave				Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	3M_I_2019	3M_II_2019	3M_III_2019	3M_IV_2019	Viti 2019	
<b>Llogaria korente</b>	<b>-811.60</b>	<b>-865.60</b>	<b>-862.90</b>	<b>-247.80</b>	<b>-283.00</b>	<b>-163.70</b>	<b>-346.40</b>	<b>-1,041.20</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-2,602.80</b>	<b>-2,824.10</b>	<b>-2,871.00</b>	<b>-694.50</b>	<b>-781.60</b>	<b>-824.60</b>	<b>-842.90</b>	<b>-3,143.60</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	713.70	797.10	986.10	209.50	242.20	226.00	229.00	906.60	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,316.50	-3,621.20	-3,857.10	-904.00	-1,023.80	-1,050.60	-1,071.90	-4,050.20	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>796.60</b>	<b>1,081.90</b>	<b>1,104.00</b>	<b>290.70</b>	<b>262.70</b>	<b>447.70</b>	<b>273.00</b>	<b>1,274.00</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	2,395.70	2,856.20	3,065.80	675.70	816.10	1,119.00	787.70	3,398.20	Services Credit
Shërbimet Debi	1,599.10	1,774.30	1,961.80	385.00	553.40	671.30	514.70	2,124.20	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>174.10</b>	<b>28.90</b>	<b>-8.60</b>	<b>-35.20</b>	<b>-12.60</b>	<b>-42.90</b>	<b>-48.80</b>	<b>-139.70</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	408.70	407.70	398.00	76.00	129.70	106.00	108.20	419.80	Income Credit
Të ardhurat Debi	-234.60	-378.80	-406.60	-111.20	-142.30	-148.90	-157.00	-559.50	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>820.50</b>	<b>847.70</b>	<b>912.70</b>	<b>191.20</b>	<b>248.50</b>	<b>256.10</b>	<b>272.30</b>	<b>968.10</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	961.20	961.80	1,002.90	220.10	274.20	280.80	298.40	1,073.50	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-140.70	-114.10	-90.20	-28.90	-25.70	-24.70	-26.10	-105.40	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>66.20</b>	<b>122.30</b>	<b>104.00</b>	<b>17.90</b>	<b>12.30</b>	<b>19.70</b>	<b>26.20</b>	<b>76.10</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>-664.30</b>	<b>-1,115.30</b>	<b>-1,145.40</b>	<b>-305.00</b>	<b>-301.10</b>	<b>-128.70</b>	<b>-76.80</b>	<b>-819.80</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	-936.50	-993.80	-1,026.00	-287.20	-227.50	-266.30	-250.00	-1,031.20	Direct Investment
Investime portofoli	225.20	-100.00	-75.10	-0.20	-82.40	93.40	129.80	140.60	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	187.40	49.00	-50.40	-17.90	4.00	39.40	35.50	53.00	Other Capital
<b>Gabime dhe harrresa neto</b>	<b>128.90</b>	<b>-186.30</b>	<b>-18.20</b>	<b>-143.80</b>	<b>-84.60</b>	<b>125.20</b>	<b>170.40</b>	<b>67.70</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>47.80</b>	<b>185.70</b>	<b>368.30</b>	<b>-68.70</b>	<b>-54.20</b>	<b>109.90</b>	<b>-73.00</b>	<b>-77.60</b>	<b>Overall Balance</b>
Rezervat	47.70	185.40	371.50	-70.70	-43.60	109.70	-73.00	-77.70	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	140.40	70.50	-6.10	-0.30	-4.80	-4.80	-7.90	-17.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 9 MJETET VALUTORE NETO**  
Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2016	2017	2018	2019	2020			Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mjetet valutore neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	426,426.9	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	418,562.1	417,605.4	436,487.8	426,984.7	423,459.0	427,650.5	451,341.2	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,968.8	24,191.7	24,867.8	24,914.3	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	65,915.7	59,998	21,779	44,589	42,832	44,354	52,159	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	34,255.6	18,407	-12,366	8,490	14,820	15,118	18,155	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	53,279.9	52,839.5	55,628.9	55,206.3	55,414.6	55,998.2	57,463.1	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	19,024.3	34,432.8	67,994.8	46,715.9	40,595.1	40,880.7	39,307.9	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,725.7	1,720.0	1,827.2	2,141.8	2,135.6	2,128.6	2,120.0	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	414,380.9	452,243.1	423,427.9	433,951.2	425,982.3	428,401.0	442,443.8	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	194.0	146.6	80.6	72.6	75.0	76.5	79.9	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	47.2	96.8	285.4	229.5	192.0	241.8	155.4	Other accounts payable
Të tjera neto	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,775	-21,185	-21,209	-21,203	Other items net
Aksione	61,859.9	45,882.2	31,088.6	33,126.1	37,035.9	39,626.2	57,109.7	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020			Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>547,602.4</b>	<b>550,280.4</b>	<b>532,628.2</b>	<b>570,553.0</b>	<b>569,030.3</b>	<b>578,622.0</b>	<b>597,387.6</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	<b>845.5</b>	<b>787.7</b>	<b>539.0</b>	<b>560.6</b>	<b>548.4</b>	<b>541.6</b>	<b>529.9</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	845.5	787.7	539.0	560.6	548.4	541.6	529.9	in Lek
Në valutë	-	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>26,863.9</b>	<b>29,515.4</b>	<b>20,270.1</b>	<b>24,182.4</b>	<b>24,452.2</b>	<b>24,548.8</b>	<b>25,032.8</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	23,993.9	24,453.5	16,594.2	18,489.7	18,911.4	19,016.3	19,046.1	in Lek
Në valutë	2,870.0	5,061.9	3,675.9	5,692.7	5,540.8	5,532.5	5,986.7	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>343,483.0</b>	<b>334,762.9</b>	<b>317,722.0</b>	<b>335,884.6</b>	<b>333,540.0</b>	<b>341,303.0</b>	<b>355,039.6</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	131,743.5	136,075.7	127,999.7	141,240.5	138,603.2	142,452.2	142,922.9	in Lek
Në valutë	211,739.5	198,687.2	189,722.3	194,644.1	194,936.8	198,850.8	212,116.7	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>8,687.6</b>	<b>7,944.6</b>	<b>10,164.0</b>	<b>13,555.1</b>	<b>13,533</b>	<b>13,707</b>	<b>14,030</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	4,242.3	3,522.3	4,802.1	8,023.8	7,837	7,878	7,890	in Lek
Në valute	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,531.3	5,696.2	5,828.8	6,140.3	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>167,722.4</b>	<b>177,269.8</b>	<b>183,933.1</b>	<b>196,370.3</b>	<b>196,956.5</b>	<b>198,521.8</b>	<b>202,755.1</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	98,722.3	108,419.1	118,744.1	130,170.0	130,778.4	131,415.3	131,138.0	in Lek
Në valutë	69,000.1	68,850.7	65,189.0	66,200.3	66,178.1	67,106.5	71,617.1	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## OFERTA E PARASË

## Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020			Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Baza monetare</b>	<b>414,380.9</b>	<b>425,243.1</b>	<b>423,427.9</b>	<b>433,951.2</b>	<b>425,982.3</b>	<b>428,401.0</b>	<b>442,443.8</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	7.9	2.6	-0.4	1.0	1.0	1.0	1.0	YY change in %
<b>Paraja jashtë korporatave deponituese</b>	<b>249,256.5</b>	<b>265,156.0</b>	<b>275,281.4</b>	<b>291,409.0</b>	<b>286,606.8</b>	<b>289,080.3</b>	<b>293,732.7</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	4.2	6.4	3.8	5.9	5.5	6.0	6.9	YY change in %
<b>Depozita</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>745,304</b>	<b>791,041</b>	<b>801,527.9</b>	<b>805,289.8</b>	<b>823,023.0</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	7.3	0.5	0.6	6.1	6.0	6.4	9.0	YY change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>435,432.3</b>	<b>461,550.1</b>	<b>478,717.6</b>	<b>523,968.3</b>	<b>522,908.1</b>	<b>528,920.4</b>	<b>536,517.2</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	13.4	6.0	3.7	9.5	8.7	9.3	10.1	YY change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>736,944.1</b>	<b>738,900.0</b>	<b>731,352.3</b>	<b>758,021.7</b>	<b>756,567.1</b>	<b>762,539.4</b>	<b>767,768.2</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	1.9	0.3	-1.0	3.6	3.3	4.0	4.3	YY change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>1,263,453.8</b>	<b>1,266,906.9</b>	<b>1,263,928.1</b>	<b>1,318,662.0</b>	<b>1,324,332.3</b>	<b>1,330,924.1</b>	<b>1,365,360.7</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	3.9	0.3	-0.2	4.3	3.9	4.1	6.8	YY change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>								<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	426,426.9	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	65,915.7	59,998.0	21,779.0	44,588.6	42,832.4	44,354.3	52,159.2	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	8,490.4	14,819.5	15,117.5	18,155.3	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera deponituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020			Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Në lekë</b>	<b>487,687</b>	<b>473,744</b>	<b>456,071</b>	<b>466,382</b>	<b>469,960</b>	<b>473,459</b>	<b>474,036</b>	<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë (D. p)</b>	<b>186,176</b>	<b>196,394</b>	<b>203,436</b>	<b>232,559</b>	<b>236,301</b>	<b>239,840</b>	<b>242,785</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,624.5	1,472.6	1,569.4	1,564.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,786.0	8,656.7	8,861.1	10,786.4	11,223.7	11,877.3	12,055.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,780.6	3,766.8	4,176.9	4,355.6	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	46,051.0	48,979.3	49,221.4	51,972.3	53,900.1	53,152.6	52,950.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	129,360.4	134,889.0	141,284.9	164,395.5	165,938.1	169,064.0	171,858.6	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>301,512</b>	<b>277,350</b>	<b>252,635</b>	<b>233,823</b>	<b>233,658</b>	<b>233,619</b>	<b>231,251</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	18.9	15.2	13.1	10.1	10.1	10.1	10.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	976.8	705.2	1,634.7	709.2	627.9	1,484.2	1,484.7	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,146.7	3,922.6	3,909.4	4,044.5	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,502.2	9,062.4	9,687.0	7,977.5	8,705.0	8,821.5	8,056.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	286,460.2	258,285.1	236,249.4	220,979.3	220,392.8	219,393.8	217,655.6	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>250,121</b>	<b>267,413</b>	<b>289,233</b>	<b>324,659</b>	<b>331,568</b>	<b>331,831</b>	<b>348,988</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	366.1	139.8	113.4	157.9	107.4	132.4	50.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	2,999.4	2,086.3	1,407.7	2,823.3	2,785.9	2,773.8	3,613.9	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,815.4	3,756.9	3,616.6	5,360.3	5,662.3	4,932.1	5,201.8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,786.9	83,945.3	84,592.0	86,698.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	171,614.8	187,242.7	206,039.8	234,530.3	239,067.3	239,400.3	253,422.8	Other resident sectors
<b>Totali</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>745,304</b>	<b>791,041</b>	<b>801,528</b>	<b>805,290</b>	<b>823,023</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,792.5	1,590.1	1,711.9	1,624.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	10,762.2	11,448.2	11,903.5	14,318.9	14,637.5	16,135.3	17,154.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,439.8	15,563.8	11,253.9	13,287.6	13,351.7	13,018.4	13,601.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	125,878.2	132,229.0	136,963.7	141,736.7	146,550.4	146,566.1	147,705.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	587,435.4	580,416.8	583,574.1	619,905.1	625,398.2	627,858.1	642,937.0	Other resident sectors

Tab - 13 **BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH**  
Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundit i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020			Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>AKTIVET</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>547,104</b>	<b>539,622</b>	<b>528,261</b>	<b>534,274</b>	<b>564,181</b>	
<b>Total</b>	<b>131,887</b>	<b>187,367</b>	<b>209,596</b>	<b>176,674</b>	<b>169,607</b>	<b>167,539</b>	<b>160,743</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	27,211.8	25,725.3	19,625.0	24,187.9	25,173.3	24,919.7	26,350.7	SDR holdings
Arka në valutë	52.0	24.3	67.1	98.3	53.0	35.6	77.8	Foreign currency
Depozitat	104,622.9	161,617.3	189,904.2	152,387.6	144,381.0	142,583.6	134,314.1	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>315,113</b>	<b>259,538</b>	<b>261,577</b>	<b>283,679</b>	<b>288,186</b>	<b>294,504</b>	<b>326,651</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	261,877.5	206,818.9	205,990.4	228,514.0	232,812.9	238,547.4	269,229.2	nonresidents
Qeveria qendrore	53,235.2	52,718.8	55,586.8	55,164.9	55,373.2	55,956.9	57,421.8	central government
<b>Huatë</b>	<b>31,660</b>	<b>41,591</b>	<b>34,145</b>	<b>36,098</b>	<b>28,012</b>	<b>29,236</b>	<b>34,003</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	31,884.0	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,725.9	1,719.8	1,827.1	2,141.4	2,134.7	2,127.5	2,118.8	Other resident sectors
<b>Derivatet financiare</b>	<b>15.8</b>	<b>11.7</b>	<b>19.3</b>	<b>13.8</b>	<b>25.3</b>	<b>31.9</b>	<b>34.8</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>25,094.1</b>	<b>23,844.9</b>	<b>21,224.9</b>	<b>22,325.3</b>	<b>21,573.6</b>	<b>22,078.1</b>	<b>21,888.0</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>20,961.2</b>	<b>20,574.7</b>	<b>20,542.0</b>	<b>20,832.0</b>	<b>20,856.9</b>	<b>20,885.3</b>	<b>20,861.8</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>547,104</b>	<b>539,622</b>	<b>528,261</b>	<b>534,274</b>	<b>564,181</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>262,031</b>	<b>278,611</b>	<b>286,209</b>	<b>303,195</b>	<b>297,287</b>	<b>299,611</b>	<b>306,310</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	258,848.0	274,711.8	286,158.4	303,092.6	297,238.9	299,550.9	306,263.2	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	3,183.2	3,899.2	50.6	102.2	48.4	59.6	46.3	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	<b>191,380</b>	<b>200,514</b>	<b>222,292</b>	<b>194,623</b>	<b>186,416</b>	<b>186,816</b>	<b>192,600</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,108.5	17,102.3	17,102.2	17,111.1	Nonresidents
Qeveria qendrore	18,975.1	34,384.3	67,945.2	46,685.3	40,543.6	40,846.6	39,274.2	Central government
Korporata të tjera depozituese	152,349.7	146,632.1	137,218.8	130,756.4	128,695.0	128,790.6	136,134.3	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	72.1	66.7	49.6	52.5	54.9	56.4	59.8	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	121.9	79.9	31.0	20.1	20.1	20.1	20.1	
<b>Huatë</b>	<b>314</b>	<b>116</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-</b>
Jorezidentët	314.2	115.6	18.3	-	-	-	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>1,164.6</b>	<b>463.8</b>	<b>518.7</b>	<b>1,690.8</b>	<b>432.6</b>	<b>1,131.5</b>	<b>596.2</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>7,981.2</b>	<b>7,340.5</b>	<b>6,977.7</b>	<b>6,987.3</b>	<b>7,089.4</b>	<b>7,090.1</b>	<b>7,566.1</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>61,859.9</b>	<b>45,882.2</b>	<b>31,088.6</b>	<b>33,126.1</b>	<b>37,035.9</b>	<b>39,626.2</b>	<b>57,109.7</b>	<b>Shares and other equity</b>

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania